

**Vendim nr. 344, datë 30.12.2025**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Asim Vokshi, Anëtar

Genti Ibrahimimi, Anëtar

në datën 30.12.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 24 (E) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** EUGEN BITRAJ, përfaqësuar nga avokat Sokol Hazizi, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 926, datë 11.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 206, datë 18.06.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2025-541, datë 01.04.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 18, pika 1, 28, pika 1, 30, 31, shkronjat “ç” dhe “d”, 32, pika 2, 42, pika 2, 122, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, 134, pikat 1 dhe 2, 141, 142, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pikat 1 dhe 2, 19 dhe 46, pika 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 43/b, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*); nenet 1, 13, 14, 15, 25, 47, 48, 48/b, 49, 50, 76, 78, 83, 300 dhe 300/1 të Kodit Penal

**(KP); nenet 1, 8/a/1/2, 58, 152, 152/3, 383/1, 390/1, 403, 405 dhe 405 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Në datën 31.07.2017, pranë stadiumit “Selman Stërmasi”, Tiranë, ka ndodhur një konflikt midis disa personave, nga i cili ka mbetur i vrarë shtetasi M.M. (viktima). Për këtë ngjarje Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*) në datën 01.08.2017, mbi materialet e dërguara nga Drejtoria e Policisë Vendore, Tiranë, ka regjistruar procedimin penal për veprat penale “Vrasja me dashje”, të kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, të parashikuara respektivisht nga nenet 76 - 25 dhe 278, paragrafi 1, të KP-së, ndaj disa personave, si edhe kërkuesit Eugen Bitraj. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria e Tiranës ka paraqitur kërkesë për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. 6008/2017 ndaj të pandehurit D.B. të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, të parashikuar nga neni 78, pika 1, të KP-së, si dhe në ngarkim të kërkuesit dhe disa pandehurve të tjerë për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300 i KP-së.

2. Në seancën paraprake, kërkuesi nëpërmjet mbrojtjes së tij ka kërkuar të gjykohet me ritin e gjykimit të shkurtuar, si dhe ndarjen e çështjes nga të pandehurit e tjerë, ndërsa, në vijim, prokurori, bazuar në parashikimet e nenit 332/d, pika 3, të KPP-së, i ka kërkuar gjykatës ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale për të cilën është akuzuar kërkuesi në “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 78, pika 1 dhe 25 të KP-së. Me vendimin e datës 28.05.2018, gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. 6008/2017 në ngarkim të kërkuesit për veprën penale “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, sipas neneve 78, pika 1 dhe 25 të KP-së.

3. Në seancën gjyqësore të datës 18.09.2018, gjykata, bazuar në nenin 93, shkronja “ç”, të KPP-së, për shkak se evidentoi nevojën e nënshtrimit të provave debatit gjyqësor, ka vendosur mospranimin e kërkesës për ndarjen e çështjes penale të kërkuesit nga të pandehurit e tjerë dhe, për pasojë, mospranimin e kërkesës për gjykimin sipas ritit të gjykimit të shkurtuar.

4. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 926, datë 11.04.2019, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Vrasja me dashje”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 76 dhe 25 të KP-së dhe dënimin e tij me 12 vjet burgim. Sipas asaj gjykate, konstatohet ekzistenca e elementeve përbërëse të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 76 i KP-së, si e atyre që lidhen me objektin dhe anën objektive të veprës penale, ashtu edhe e atyre që lidhen me subjektin dhe anën subjektive të saj dhe se vepra penale është kryer në bashkëpunim. Në lidhje me caktimin e llojit të masës së dënimit ajo gjykatë ka vlerësuar edhe rrezikshmërinë e theksuar shoqërore të kërkuesit, shprehur kjo jo vetëm me faktin e kryerjes me dashje të drejtpërdrejtë, por dhe në bashkëpunim, si dhe pasojën fatale të ardhur prej saj. Gjykata ka identifikuar edhe disa rrethana lehtësuese ndaj kërkuesit, duke i mbajtur ato parasysh në caktimin e llojit dhe masës së dënimit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi dhe prokuroria.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 206, datë 18.06.2020, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se në analizë të provave të administruara në gjykim, kërkuesi është autor i veprës penale për të cilën akuzohet, të kryer në bashkëpunim, pavarësisht rolit që ka kryer secili prej bashkëpunëtorëve në realizimin e veprës penale me veprimet ose mosveprimet e tij. Gjykata e apelit e ka gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë edhe lidhur me masën e dënimit, duke marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuesi dhe prokuroria.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin 00-2025- 541, datë 01.04.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

7. Në datën 01.09.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 12.09.2025.

## II

### **Pretendimet e kërkuesit**

8. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 8.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar pretendimin e kërkuarit për refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar nga gjykata e shkallës së parë, edhe pse ekzistonin kushtet e nenit 406/1 të KPP-së.
- 8.1.2. *Së drejtës për t'u njoftuar dhe dëgjuar të lidhur me të drejtën e mbrojtjes dhe parimin e barazisë së armëve e kontradiktoritetit*, pasi kërkuari nuk është njoftuar për rekursin e prokurorisë, duke mos pasur mundësi për të paraqitur prapësimet e tij për pretendimet e palës tjetër në gjykim, siç është vërtetuar edhe nga procesverbali i seancës gjyqësore. Duke mos u njoftuar për rekursin, kërkuari është vendosur në pamundësi të paraqesë prova e fakte, si dhe prapësimet e tij për çështjet ligjore të ngritura në recurs. Kolegji Penal është mjaftuar vetëm me komunikimin e datës së shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit.
- 8.1.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e faktit nuk kanë analizuar elementet e veprës penale dhe më konkretisht anën subjektive të saj. Ato kanë gabuar në cilësimin juridik të veprës penale të kryer “në bashkëpunim”, si dhe kanë deformuar e keqinterpretuar pamjet filmike me qëllim, pa i gërshetuar me provat e tjera, duke mos shqyrtuar me korrektësi provat që fajësojnë ose shfajësojnë atë. Mungesa e argumentit ligjor në vendimet e gjykatave të faktit për përmbushjen e elementeve subjektive të veprës penale përbën një të metë të arsyetimit të vendimeve të tyre, të cilave u mungon harmonia e brendshme. Gjykatat kanë përdorur termin “homogjenizimit të kushtëzuar”, i cili bie ndesh me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse në rastin e kërkuarit është përdorur në kundërshtim me standardet njerëzore.
- 8.1.4. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykatat e faktit kanë arritur në konkluzion apriori për fajësinë e kërkuarit, duke u dhënë provave dhe dëshmive të administruara në gjykim vlerë të paracaktuar, pavarësisht se kërkuari gjatë gjithë gjykimit ka pretenduar se është i pafajshëm. Gjykatat e kanë paragjykuar çështjen dhe pa arsyetuar mbi çdo provë, madje në kundërshtim me nenin 152, pika 3, të KPP-së, e kanë përfshirë kërkuarin në veprën e vrasjes në bashkëpunim. Edhe Kolegji Penal e ka nisur procesin me bindjen se kërkuari është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.
- 8.1.5. *Parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (reformatio in peius)*, për shkak të moskomunikimit të rekursit kërkuarit dhe mbrojtësit të tij.

- 8.1.6. *Parimit të ligjshmërisë së marrjes së provave*, pasi për kërkuesin nuk ka ndonjë provë, e cila lë të kuptosh se ka elemente të institutit të bashkëpunimit të kryerjes së veprës penale të vrasjes me dashje si në aspektin objektiv ose subjektiv. Gjithë fakti penal shfaqet i individualizuar në veprimet e çdo subjekti të veprës penale në pamjet filmike. Gjykatat e faktit kanë gabuar ose kanë keqzbatuar ligjin penal, sepse në asnjë veprim të kërkuesit nuk konstatohet të jenë kryer akte, veprime ose lëvizje nga të cilat të ketë ardhur pasoja e humbjes së jetës së viktimës. Për kërkuesin mungon ana subjektive e bashkëpunimit në realizimin e veprës penale, si dhe vullneti për të kontribuar me veprimet e tij në vrasjen e viktimës M.M., ndaj ai duhej të ishte deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Moskallëzimi i krimit”.
- 8.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, pasi gjykatat e zakonshme duke mos konstatuar shkeljet ligjore në procesin gjyqësor kanë diskriminuar kërkuesin, të cilit i është rënduar pozita pa fakte dhe prova.

### III

#### Vlerësimi i kërkuesit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe si bartës i të drejtave të pretenduara të cenuara ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në drejtim të shterimit të mjeteve juridike efektive, Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, pretendim të cilin nuk e ka ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këto rrethana, për këtë pretendim kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive dhe për këtë qëllim ai nuk mund të merret në shqyrtim. Ndërsa pretendimet e tjera kërkuesi i ka ngritur në thelb në rekurs, ndaj, për rrjedhojë, do të vlerësohen në vijim, pasi kanë përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

13. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit gjyqësor i dhënë në çështjen e tij, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 01.04.2025, i cili, sipas kërkuesit i është komunikuar në datën 27.06.2025, kurse kërkesa është regjistruar në Gjykatë në datën 12.09.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt, duke pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit, së drejtës për t’u njoftuar dhe dëgjuar të lidhur me të drejtën e mbrojtjes dhe parimin e barazisë së armëve e kontradiktoritetit, parimit të prezumimit të pafajësisë, parimit të mosrëndimit të pozitës të të pandehurit, mënyrës së marrjes së provave dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

15. Kërkuesi në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe mënyrën e marrjes së provave ka pretenduar se nuk ekziston ndonjë provë e cila lë të kuptosh se ka elemente të institutit të bashkëpunimit të kryerjes së veprës penale të vrasjes me dashje, si në aspektin objektiv ose subjektiv. Gjithë fakti penal shfaqet i individualizuar në veprimet e çdo subjekti të veprës penale në pamjet filmike. Për kërkuesin mungon ana subjektive e tij për të bashkëpunuar me ekzekutorin në realizmin e vrasjes së shtetasit M.M. Mosveprimi i kërkuesit është i qartë, sepse prania e tij në vendin e ngjarjes gjatë kohës që ka ndodhur fakti kriminal është konstatuar kryesisht nga organi i akuzës. Gjykatat në vendimet e tyre kanë

gabuar në kuptim të cilësimit juridik të veprës penale “në bashkëpunim”, si dhe kanë deformuar dhe keqinterpretuar pamjet filmike, pa i gërshetuar me provat e tjera në hetim dhe gjykim, duke mos shqyrtuar me korrektësi provat që e fajësojnë ose jo atë. Sipas tij, gjykatat kanë arritur në konkluzion apriori për fajësinë e tij, duke u dhënë provave një vlerë të paracaktuar. Sipas tij, ato kanë paragjykuar çështjen dhe pa arsyetuar mbi çdo provë, madje në kundërshtim me nenin 152, pika 3, të KPP-së, e kanë përfshirë kërkuesin në veprën e vrasjes në bashkëpunim. Edhe Kolegji Penal e ka nisur procesin me bindjen se kërkuesi është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

16. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit, çmuarja e provave, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit për proces të rregullt ligjor. Çmuarja e provave për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbën juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 45, datë 23.07.2012; nr.31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, në mënyrë konstante Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, pasi Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe bazuar në përmbajtjen e argumenteve të paraqitura nga kërkuesi në mbështetje të këtyre pretendimeve, Kolegji çmon se në thelb, ato kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe, si të tilla, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Po ashtu, në lidhje me pretendimin e prezumimit të pafajësisë vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të kërkuesit, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, këto pretendime të kërkuesit janë haptazi të pabazuar.

18. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se ai nuk është njoftuar për rekursin e prokurorisë, duke mos pasur kështu mundësi për të paraqitur prova e fakte, si dhe prapësimet e tij për çështjet ligjore të ngritura në rekurs. Po sipas kërkuesit, Kolegji Penal është mjaftuar

vetëm me komunikimin e datës së shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, pa i komunikuar paraprakisht rekursin e ushtruar nga organi i prokurorisë. Për rrjedhojë, për shkak të moskomunikimit të rekursit kërkuesit i është cenuar e drejta për t'u njoftuar dhe dëgjuar e lidhur me të drejtën e mbrojtjes dhe parimin e barazisë së armëve e kontradiktoritetit, si dhe parimi të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*reformatio in peius*).

19. Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë, në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 6, datë 27.01.2017; nr. 34, datë 25.07.2011; nr. 34, datë 03.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht në procesin penal mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, prandaj për respektimin e tyre gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimin nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga aktet dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi rezulton sesi kërkuesi, ashtu edhe prokuroria e apelit i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me recurs për kundërshtimin e vendimit të gjykatës së apelit. Me dëftesën e komunikimit të datës 11.01.2021 i është komunikuar avokatit të kërkuesit recursi i paraqitur nga prokuroria e apelit, i cili është nënshkruar nga avokati S.H. në datën 04.02.2021. Ky avokat ka paraqitur si rekursin në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të gjykatës së apelit, ashtu edhe ankimin individual në Gjykatë. Për rrjedhojë, rezulton se kërkuesi, përmes mbrojtësit të tij, në ndryshim nga sa pretendon në ankimin kushtetues, ka marrë dijeni për rekursin e palës tjetër në Gjykatën e Lartë, duke pasur të gjitha mundësitë që të parashtrrojë pretendimet e tij në lidhje me shkaqet e parashtruara nga akuza. Për më tepër, Gjykata e Lartë ka vendosur për mospranimin e rekursit të prokurorit, ndaj nga kjo pikëpamje nuk rezulton që kërkuesit t'i ketë ardhur ndonjë pasojë në të drejtën e tij për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim është haptazi i pabazuar.

21. Kërkuesi ka pretenduar, në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, se gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar pretendimin për refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar nga gjykata e shkallës së parë edhe pse ekzistonin kushtet

e nenit 406/1 të KPP-së. Sipas tij, gjykatat e faktit nuk kanë analizuar elementet e veprës penale dhe më konkretisht anën subjektive të saj. Mungesa e argumentit ligjor në vendimet e gjykatave të faktit për përmbushjen e elementeve subjektive të veprës penale përbën një të metë të arsyetimit të vendimeve të tyre, të cilave u mungon harmonia e brendshme.

22. Lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse ajo, para së gjithash, është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimin nr. 31, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa për procedurën e gjykimit të shkurtuar, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se kur i pandehuri ka bërë kërkesë që të procedohet me këtë lloj gjykimi, nëse gjykata e zakonshme çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa iu nënshtruar provat debatit gjyqësor dhe pa marrë prova të reja, vlerësim i cili konsiston në bindjen e brendshme të gjyqtarit, vendos gjykimin e shkurtuar. Pra, gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili nëse ka dyshime mbi këtë vlerësim, kjo mjafton që ai të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme, duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor. Po ashtu, sipas vendimit unifikues nr. 2/2003 të Gjykatës së Lartë, gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin, uljen me 1/3-ën e masës së dënimit dhe mosaplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm. Ky përfitim nuk duhet kurrsesi të shkojë në dëm të dhënies të drejtësisë (*shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Për sa i përket arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë, funksioni i të cilit është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në

mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se ky detyrim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Kolegji, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, vëren se kërkuesi është dërguar për gjykim fillimisht me akuzën e “Moskallëzimit të krimit”. Në seancën datës 22.05.2018 prokurori ka kërkuar ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale “Moskallëzimi i krimit” ndaj kërkuesit dhe dërgimin për gjykim nën akuzën “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 78, pika 1 dhe 25 të KP-së. Në seancën e datës 18.09.2018 përpara gjyqtarit të seancës paraprake kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësit të tij, ka paraqitur kërkesë për zhvillimin e gjykimit me procedurë të shkurtuar, si dhe ndarjen e çështjes së tij nga ajo për të pandehurit e tjerë. Gjykata e shkallës së parë, mbështetur në nenin 93, pika “ç”, të KPP-së, në kushtet që ka konstatuar nevojën që provat t’i nënshtrohen debatit gjyqësor, ka vendosur të rrëzojë kërkesën e kërkuesit për t’u gjykuar sipas rritit të gjykimit të shkurtuar dhe për ndarjen e procedimeve. Ajo, bazuar në nenin 375 të KPP-së, ka motivuar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, duke argumentuar se mënyra, vendi dhe koha e kryerjes së saj, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, lidhja shkakësore midis veprimit dhe pasojës së ardhur janë evidente për mungesën e elementit “paramendim”, si dhe dëshirës së paramenduar për të ardhur pasojë. Në vendimin përfundimtar faktit juridik duhet t’i jepet një përcaktim i ndryshëm nga ai i bërë nga organi i akuzës, duke u ndryshuar cilësimi juridik i veprës penale nga neni 78/1 dhe 25 i KP-së në nenet 76 dhe 25 të atij kodi dhe konkretisht kërkuesi duhet të përgjigjet për kryerjen e veprës penale të vrasjes me dashje, të kryer në bashkëpunim, pikërisht për pasojën që ai solli me veprimet e tij kriminale, pasojë e cila përcaktohet edhe në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor. Në analizën e saj gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar edhe qëndrimin në lidhje me pretendimet e mbrojtjes që midis kërkuesit dhe të pandehurve të tjerë nuk ekziston bashkëpunimi, duke vlerësuar se mbështetur në kriteret e vendosura nga ligjvënësi, si dhe në zbatim të praktikës gjyqësore dhe vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 4/2011, vepra penale për të cilën akuzohet kërkuesi është kryer në bashkëpunim. Edhe në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit për kërkuesin ajo gjykatë ka mbajtur parasysh kërkesat e nenit 47-50 të KP-së, rrezikshmërinë e theksuar të veprës penale, si dhe raportet shoqërore që ajo cenon, të vendosura në mbrojtje të jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe veçanërisht përhapjen e saj, si dhe rrethanat lehtësuese që kërkuesi figuron pa precedentë penalë të mëparshëm dhe vetëdorëzimin e tij (*shih faqet 10-16 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*).

25. Gjykata e apelit, e vënë në lëvizje me ankimet e kërkuesit dhe të prokurorisë, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi ka vlerësuar provat e administruara në gjykim, si dhe pretendimet e palëve në lidhje me faktin penal, duke çmuar se kërkuesi është autor i veprës penale “Vrasja me dashje”, të kryer në bashkëpunim, pavarësisht rolit që ka kryer secili prej bashkëpunëtorëve në realizimin e veprës penale me veprimet ose mosveprimet e tij. Kjo gjykatë e ka gjetur të drejtë dhe proporcionale masën e caktimit të dënimit nga gjykata e shkallës së parë, duke marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, atë të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Po ashtu, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata e apelit, pasi ka marrë në shqyrtim edhe pretendimet e kërkuesit të ngritura në ankim në drejtim të vendimmarrjes së shkallës së parë, i ka gjetur ato të pabazuara.

26. Për rekursitet e kërkuesit dhe të prokurorisë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tyre, duke i vlerësuar të pabazuara shkaqet e ngritura në to, duke rikonfirmuar qëndrimin se pretendimet që lidhen me mënyrën e vlerësimit të fakteve dhe provave dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të asaj gjykate. Sipas Kolegjit Penal, gjykatat e apelit, në mbështetje të argumenteve të gjykatës së shkallës së parë, ka analizuar në mënyrë shteruese elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 76 i KP-së në raport me veprimet dhe mosveprimet e kërkuesit, duke evidentuar elementet e bashkëpunimit të parashikuara nga neni 25 i KP-së. Në lidhje me këtë rrethanë të bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale ato i janë referuar veprimeve konkrete të të pandehurve në realizimin e veprës penale dhe ardhjen e pasojës, duke mbajtur në konsideratë këto veprime me konkluzionet e vendimit unifikues nr. 04/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të asaj gjykate. Më tej, Kolegji Penal ka vlerësuar se gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrim të njëjtë në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal për të cilin janë deklaruar fajtorë dhe ndryshe nga sa pretendojnë të pandehurit ato gjykata kanë arritur në një përfundim të drejtë dhe të bazuar në ligj në lidhje me çështjen në shqyrtim pas analizës së veprimeve të kryera prej këtyre të fundit në raport me provat e verifikuara në gjykim. Po ashtu, gjykatat më të ulëta kanë arsyetuar vendimmarrjen e tyre në përputhje me përcaktimet e nenit 152 të KPP-së, pa mbivlerësuar asnjë provë, si dhe duke u dhënë përgjigje pretendimeve të të pandehurve. Edhe në lidhje me qëndrimin refuzues të gjykatave ndaj kërkesës së të pandehurit për gjykimin me ritin procedural të gjykimit të shkurtuar, ai kolegji ka vlerësuar se është në diskrecionin e gjykatave më të ulëta, për sa kohë ka të bëjë me vlerësimin dhe çmuarjen, në thelb, të zgjidhjes së çështjes në gjendjen e akteve, si kusht i parashikuar nga neni 405, paragrafi 6, i KPP-së për pranimin e këtij riti procedural, ndaj është i pacenueshëm nga karakteri ekskluzivisht ligjor i Gjykatës së Lartë. Në përfundim, Kolegji Penal vlerëson se në vendimet e gjykatave më të

ulëta nuk konstatohet mosrespektimi ose zbatimi i gabuar i ligjit material ose procedural me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk konstatohet mosrespektimi ose zbatimi i gabuar i ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk rezulton që vendimi i gjykatës së apelit të bjerë në kundërshtim me praktikën e asaj gjykate (*shih paragrafët 32-42 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

27. Në kuptim të standardeve të mësipërme dhe referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore të dhëna në çështjen e kërkuarit, Kolegji vlerëson se ato tregojnë mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranura dhe përfundimet e nxjerra prej tyre, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ato janë bazuar në zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Po ashtu, ato gjykata kanë arritur në përfundimin se kërkuari ishte autor i veprës penale, duke analizuar për këtë qëllim në vendimet e tyre përmbajtjen e provave të shqyrtuara dhe duke shpjeguar sesi ato lidheshin me njëra-tjetrën, pa i dhënë ndonjëherë prej tyre vlerë të paracaktuar. Ato kanë përcaktuar fajësinë e kërkuarit përtej dyshimeve të arsyeshme, bazuar në një mori provash, përmbajtja e të cilave është analizuar dhe arsyetuar mjaftueshëm. Gjykatat kanë vlerësuar provat dhe pretendimet e palëve, përfshirë edhe ato të kërkuarit, dhe në analizë të tyre kanë zbatuar në vijim ligjin penal ndaj tij. Provat mbi të cilat gjykatat kanë mbështetur vendimet e tyre janë pikërisht ato që i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe në formën e kërkuar nga ligji. Gjykatat e faktit kanë arsyetuar edhe për çdo kërkesë procedurale të kërkuarit. Nisur nga kjo, gjykatat e faktit që kanë deklaruar fajtor dhe dënuar kërkuarin kanë përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimeve, ndërkohë që interpretimi i ligjit prej tyre, i shprehur përmes arsyetimit të vendimit, nuk duket të jetë i paarsyeshëm ose eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Në këtë drejtim Kolegji vlerëson, gjithashtu, se edhe pse gjykata e apelit nuk i ka dhënë përgjigje të shprehur pretendimit të kërkuarit për refuzimin e gjykimit të shkurtuar, ajo, pasi e ka shqyrtuar në tërësi ankimin, i ka gjetur të pabazuara shkaqet e tij.

28. Edhe për sa i përket vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit në funksion të shqyrtimit paraprak të rekursit, Kolegji vlerëson se ai tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe në pjesën arsyetuese argumentet ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, sikundër edhe arsyetimit të kufizuar për to, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuari është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, duke i dhënë

përgjigje të shprehur edhe pretendimit për refuzimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar (*shih paragrafin 26 më sipër*). Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

29. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.